

**Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe II**

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ALB 102	B	2	4	0	0	4.00	5
<b>Lektori dhe orari i konsultimeve</b>			Jolanda Lila, PhD Candidate				
<b>Asistenti dhe orari i konsultimeve</b>			Alba Borici, MA				
<b>Gjuha e kursit</b>			Albanian				
<b>Niveli i lëndës</b>			Bachelor				
<b>Përshkrimi</b>			Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës na ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të mirë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në shkrimin e shqipes dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm.				
<b>Objektivat</b>			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit.</li> <li>• Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore.</li> <li>• Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjërimin normativ.</li> <li>• Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome).</li> <li>• Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde.</li> </ul>				

**Programi i Lëndës**

Java	Tema
1	Pikësimi në fjalinë e thjeshtë - Pikësimi i periudhës dhe paragrafëve të gjatë
2	Ç'është teksti? - Fazat e krijimit të tekstit - Nocioni "tekst" dhe evolucioni i tij - Organizimi i brendshëm i tekstit
3	- Kriteret dhe parimet e tekstualitetit - Kohezioni dhe koherenca. Elementet e tyre karakterizuese
4	Rimarrja - Paralelizmi - Parafraza - Proforma
5	Koha, aspekti, veprimi - Mënyrat e veprimit foljor - Tipologjia dhe klasifikimi i teksteve
6	Respekti në gjuhë, ose mirësjellja gjuhësore - Respekti në sferën profesionale - Fjalori i rënduar i mediave
7	Gjuhët kombëtare dhe gjuha zyrtare në Bashkimin Evropian - Anglishtja në kuadrin e BE-së - Cili është koncepti i De Mauros?
8	Provimi Gjysmë-Final
9	Institucionet dhe mjetet që përçojnë normat e shqipes standarde - Stilet e shqiptimit - Diksioni
10	Ushtrime për të shkathëtësuar dhe ngulitur drejtshqiptimin - Fjalëshpejtat - Defekti i të folurit shpejt - Frymëmarrja - Zëri
11	Theksimet - Theksi logjik - Tema/rema
12	Stilet funksionale të gjuhës shqipe - Fjalët asnjane dhe fjalët me shenjë stilistike - Stilema dhe llojet e ligjërimin
13	Teksti dhe domethënie nëntekstore - Mjetet shprehëse gjuhësore të zhanreve të ndryshme
14	Si të shkruajmë një ese? - Organizimi i paragrafëve dhe i nënçështjeve - Përmbledhje e skicë-idesë
15	Strategjitë e përkufizimeve - Llojet e përkufizimeve - Termat kyçe dhe termat e papërcaktuar
16	Provimi Final
<b>Parakushtet</b>	

<b>Literatura</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1. Cikël leksionesh nga lektori i lëndës. (Ky cikël leksionesh është hartuar duke u bazuar si në literaturën e detyrueshme, ashtu edhe në atë të këshillueshme, pra është një përmbledhje e koncepteve themelore të lëndës).</li> <li>• 2. Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2002.</li> <li>• 3. Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFA, 2004.</li> </ul>		
<b>Referenca të tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë: SHBLU 2006.</li> <li>• Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Tiranë: shtëpia botues "Shkenca", 1999</li> <li>• Robert Elsie, Historia e Letërsisë shqiptare.</li> <li>• Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë: SHBLU, 1988, f. 247-276</li> </ul>		
<b>Punë laborator</b>			
<b>Përdorimi i komp.</b>			
<b>Të tjera</b>			
<b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>			
<b>1</b>	Studentët do të pajisen me njohuritë bazë të gjuhës dhe do të dinë të shkruajnë pa gabime drejtshkrimore.		
<b>2</b>	Studentët do të mund të përkthejnë më mirë nga gjuhët e huaja tekste të ndryshme, duke njohur në mënyrë rrënjësore gjuhën amtare.		
<b>3</b>	Studentët do të arrijnë të shkruajnë ese, njoftime, deklarata etj., në mënyrë koherente dhe të saktë.		
<b>Mënyra e Vlerësimit të Lëndës</b>			
	<b>Notat e Ndërmjetme</b>	<b>Sasia</b>	<b>Përqindja</b>
	Gjysmë finale	1	20
	Kuize	4	20
	Projekte	0	0
	Projekte semestrare	0	0
	Punë laborator	0	0
	Pjesëmarrja në mësim	1	10
	<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>50</b>
	<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>50</b>
	<b>Total</b>		<b>100</b>
<b>Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)</b>			
	<b>Aktivitetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Kohëzgjatja (orë)</b>
	Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	64
	Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	42
	Detyra	0	0
	Gjysmë finale	1	10
	Provimi final	1	10
	Të tjera	0	0
	<b>Ngarkesa totale e orëve</b>		<b>126</b>
	<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>		<b>5,04</b>

<b>ECTS</b>	<b>5</b>
-------------	----------